



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

&

KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Forcimi i kuadrit rregullator për kontrollet zyrtare, kategorizimin e subjekteve, si dhe kuadrin ligjor për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve në Shqipëri, në kontekstin e procesit të negociatave

28 prill 2026

Salla Grand Imperial 2, Xheko Imperial Hotel

10:00 - 12:30

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) dhe Qendra ALERT kanë kënaqësinë t'ju ftojnë të merrni pjesë në tryezën e diskutimit mbi **Kapitullin 12 – Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve**, në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin European dhe Konventës Kombëtare për Integrimin European.

Në vazhdim të përmbushjes së standardeve europiane, të cilat burojnë nga procesi i negociatave për këtë kapitull, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka përfunduar procesin e konsultimit publik për projektligjin **“Për kontrollet zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë”**, i cili synon përafrimin e pjesshëm me Rregulloren Europiane (BE) 2017/625 mbi kontrollet zyrtare. Në vijim të kësaj nisme, është i nevojshëm diskutimi i mëtejshëm mbi përmirësimin e kuadrit rregullator në këtë fushë. Një pjesë e rëndësishme e diskutimit do t'i kushtohet gjithashtu temës së **kategorizimit të subjekteve në plotësimin e standardeve të BE-së**, si dhe mënyrave të përmirësimit të qasjes rregullatore në funksion të lehtësimit të barrës administrative dhe rritjes së efektivitetit të kontrollit.

Gjithashtu, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në forcimin e kuadrit ligjor në fushën veterinare, përmes miratimit të **ligjit nr. 41/2025 “Për shëndetin e kafshëve”**, i cili përbën përafrim me Rregulloren (BE) 2016/429 (“Animal Health Law”). Ky ligj vendos një qasje të integruar dhe të bazuar në risk për **parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të kafshëve**, duke forcuar përgjegjësitë e operatorëve dhe autoriteteve kompetente. Zbatimi i këtij kuadri të ri ligjor përbën një hap të rëndësishëm jo vetëm në përmirësimin e sistemit kombëtar të mbrojtjes së shëndetit të kafshëve, por edhe në rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së produkteve me origjinë shtazore në tregjet vendase dhe ndërkombëtare.

Ftojme të gjitha grupet e interesit të konfirmojnë pjesëmarrjen në adresën: info@em-al.org.

**Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 12 organizohen në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin European”.*

**Kjo tryezë zhvillohet në kuadër të projektit “Linja e gjelbër për mbrojtjen e konsumatorit – Siguria ushqimore dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të OSHC-ve lokale”, financuar nga Bashkimi Evropian (IPA III/2024), që po zbatohet nga Qendra Alert në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).*



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN &

KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Forcimi i kuadrit rregullator për kontrollet zyrtare, kategorizimin e subjekteve, si dhe kuadrin ligjor për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve në Shqipëri, në kontekstin e procesit të negociatave

28 prill 2026

Salla Grand Imperial 2, Xheko Imperial Hotel

10:00 - 12:30

Orari

Tematika

09:45 - 10:00

REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE

10:00 - 10:30

FJALA PËRSHËNDETËSE

- Gjendja aktuale e Kapitullit 12 dhe kryerja e kontrolleve zyrtare për të garantuar një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve
- Roli i shoqërisë civile në monitorimin dhe rritjen e transparencës në këtë sektor

Z. Arian Jaupllari, Zv. Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Negociator i Kapitullit 12

Z. Granit Sokolaj, Drejtor Ekzekutiv, Qendra ALERT

Z. Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

10:30 - 11:10

PËRMBUSHJA E STANDARDEVE EUROPIANE PËR SIGURINË USHQIMORE DHE KATEGORIZIMI I SUBJEKTEVE

- Zhvillimet më të fundit në fushën e sigurisë ushqimore
- Përafrimi i projektligjit me Rregulloren Europiane (BE) 2017/625 mbi kontrollet zyrtare
- Qëllimi dhe metodologjia për vlerësimin e kategorizimit të stabilimenteve

Znj. Luljeta Çuko, Drejtore, Drejtoria e Politikave të Sigurisë Ushqimore, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN &

KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Forcimi i kuadrit rregullator për kontrollet zyrtare, kategorizimin e subjekteve, si dhe kuadrin ligjor për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve në Shqipëri, në kontekstin e procesit të negociatave

28 prill 2026

Salla Grand Imperial 2, Xheko Imperial Hotel

10:00 - 12:30

Orari

Tematika

11:10 - 11:40

**HARTIMI I LIGJIT PËR SHËNDETIN E KAFSHËVE,
PËRMIRËSIMI DHE ZBATIMI I LEGJISLACIONIT PËR
MIRËQENIEN E KAFSHËVE NË FUNKSION TË
PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE EUROPIANE**

- Ligji “Për shëndetin e kafshëve”, në përputhje me Rregulloren (BE) 2016/429
- Përmirësimi i kuadrit ligjor për mirëqenien e kafshëve si pjesë integrale e sistemit veterinar dhe kërkesave të BE-së

Znj. Matilda Xhepa, Drejtore e Politikave Veterinare,
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

11:40 – 12:10

DISKUTIM I HAPUR ME PJESËMARRËSIT

12:10 – 12:30

MBYLLJA E AKTIVITETIT DHE KOKTEJL

**Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 12 organizohen në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian”.*

**Kjo tryezë zhvillohet në kuadër të projektit “Linja e gjelbër për mbrojtjen e konsumatorit – Siguria ushqimore dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të OSHC-ve lokale”, financuar nga Bashkimi Evropian (IPA III/2024), që po zbatohet nga Qendra Alert në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).*